



PROCESVERBAL V/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së V (pestë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 21.05.2024
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Qendër” në Suharekë;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të “Hisarit” në Suharekë;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale në pronën private;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e Artë” , “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershor” ;**
- 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2023 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. ;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe thotë që është një pikë shtesë. Është kërkesë për ta subvencionuar një familje të cilës iu ka djeg shtëpia në Bllacë. Jemi mundu nëpërmjet formave tjera me rregullu, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike mirëpo nuk kanë pas mundësi dhe e kemi sjell këtu.

Bulëza Kuçi - kërkesë e kujt është?

Kryesuesi - kërkesa është e palës. Kryesuesi e hedh në votim pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Qendër” në Suharekë;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - a e keni seriozisht me këtë projektvendim për shkak se Zona Qendër e komunës së Suharekës që është në komunat e vogla në kuadër të Republikës së Kosovës i paska 493 hektar, që po besoj që as Prishtina nuk i ka aq ha. Kjo e ka përfshi komplet qytetin dhe nuk është në përputhje me hartën zonale dhe mua nuk më duket në rregull. Përveq që ky zgjerim më duket i paarsyeshëm, nuk më duket e arsyeshme me shpenzu mjete financiare, staf shtesë për me hartu një plan që ato kushte i definojnë harta zonale. Planet rregulluese janë nëse ka nevojë komuna në zona të caktuara, ka një interes të caktuar p.sh Zonat Industriale ose Zona Qëndrore por jo krejt zona urbane sepse nuk ka nevojë. Mungesa e zyrtarëve të urbanizmit apo e Drejtorit të Urbanizmit në KPF është e paarsyeshme sepse ne si KPF e meritojmë një sqarim. Njëjtë është edhe për Hisarin edhe pse Hisarin e kishim përfill pak a shumë zonat dhe nuk kishim dalë përtej asaj.

Liridon Fandaj - nëse është një plan rregullues në Hartë Zonale atëherë edhe ministria nuk del prej asaj por nëse është ashtu si po thotë Sania, është e pakuptimtë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - nuk ka plan rregullues. HZK i definojnë kushtet ndërtimore se çka ke të drejtë me ndërtu por HZK thotë që nëse komuna ka zona me interes mund të trajtohet më detalisht se HZK-ja. Ne atëherë kur e kemi hartu HZK-në i kemi fut komplet këto lagje por na ka heq dhe e ka reduktu komplet listën. Mua më duket e paarsyeshme dhe e qëllimshme sepse nuk besoj që nuk e ka analizu drejtorja këtë çështje. Vota ime nuk është për.

Avni Bytyqi - atë që e tha Sania qëndron ashtu. Nëse nuk është e planifikuar me HZK dhe e ka tejkalu Zonën Qendër ju garantoj që në Ministri nuk e merr konfirmimin. Është mirë me kohë me i eliminu këto të meta dhe duhet ti përmbahemi dispozitave që i parasheh HZK-ja sepse HZK-ja dhe PZHK-ja për ne është ligj.

Sanie Kuçi Rexhepaj - drejtori duhet me qenë patjetër kur është një pikë e rendit të ditës. Për secilin inicim të procedurave ne na duhen një planprogram i shkurt se çfarë synimi ka drejtorja me realizu përmes atij dokumenti që don ta hartoj sepse për atë dokument ne do ta japim votën finale.

Urim Suka - shumicën e gjërave i tha Sania për të cilat unë pajtohem. Kjo pikë mbledhjen e kaluar na ka ardhë me zona të ndara mirëpo ministria ka kërku me bë bashkë dhe me përfshi si një zonë. Tash ka ardhë si një zonë dhe nëse tash e ka tejkalu zonën qendër, është diçka tjetër. Një prej çështjeve që pata me ngrit ishte që me pyet drejtorin se çka konkretisht po mendon me këtë planifikim dhe çka përfiton komuna. Ne në parim si LDK gati në të gjitha projekt-vendimet e tilla që kanë ardhë, e kemi dhënë mbështetjen dhe në parim jemi për me i dhënë por gjithmonë drejtorja duhet me i dhënë sqarimet e veta dhe mos me na u kthi vazhdimisht vendimet nga ministria.

Kryesuesi - herën e kaluar i kemi sjell por i kemi tërheq nga rendi i ditës.

Urim Suka - po ai na ka thënë që ka komunikuar me ministrinë dhe i ka tërheq. Në këto rrethana, pa i pas sqarimet e nevojshme ne nuk e votojmë një projekt-vendim të tillë.

Avni Bytyqi - ju sugjeroj që ta dërgoni në kuvend me kushtin që drejtori me arsyetuar ose të kundërtën me tërheq vendimin dhe me përfshi vetëm zonën qendër ashtu siç tha Sania.

Kryesuesi - ne mund ta diskutojmë atje dhe të vendosim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - drejtorja ka edhe zyrtar të tjerë që janë të përfshirë në proces dhe mundet me delegu një zyrtar në mbledhjen e KPF-së dhe me dhënë sqarime që ne kemi nevojë.

Bulëza Kuçi - edhe unë kisha thënë me përcjell për Asamble.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

**5 për, 2 kundër
Miratohet pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të "Hisarit" në Suharekë;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

**5 për,1 kundër,1 abstenim
Miratohet pika 3**

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale në pronën private;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - ka ardhë si pikë mbledhjen e kaluar dhe drejtoria e urbanizmit ka thënë që komuna përfiton sepse jep më pak e merr më shumë. Tani në bazë të vlerësimit që ministria e ka bërë, po i bie që Komuna duhet me pagu një pjesë shtesë. Nëse ne e kemi votu, kemi ra në lajthitje dhe drejtori është dashtë të na sqaroj në fillim edhe pse nuk është vlerë shumë e madhe.

Armend Krasniqi - Ministria e ka vlerësuar pronën të cilën ne e kemi dërgu me vlerësu dhe në kuadër të vlerësimit të ministrisë nuk është nda në mënyrë të barabartë por prona që është dhënë më shumë nga pronari faktikisht duhet të kompenzohet nga Komuna. Pajtohemi me Liridonin por me pronarin kur e kemi mbajtur një takim ka thënë që edhe nëse më bie pak më shumë me marrë ose më pak me dhënë, ka thënë që unë do ta ndaj në pjesë të barabarta. Me korrektësinë dhe sinqeritetin pronari i asaj prone duhet ato 4000€ me ia fal komunës mirëpo nuk e di a duhet të përgatitet ndonjë vendim apo jo.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Armend Krasniqi - 4 banesat të cilat janë në rrugën "Brigada 123" kanë qenë banesa të uzurpuara ku nuk ka inkasu asnjë të hyrë komuna që nga viti 2002. Me iniciativën time kam marrë vendim që ti largoj uzurpatorët dhe kam arritur që t'ia kthej pronën e uzurpuar komunës. Kemi bërë regjistrimin e kësaj prone në kataster dhe ne kemi marrë iniciativë që këto banesa të shkojnë tutje në ankand publik, kryesisht të destinuara për familjet e dëshmorëve mirëpo patjetër duhet ti nënshtrohet ligjit.

Dardan Berisha - a është komisioni i formuar?

Armend Krasniqi - jo.

Liridon Fandaj - nëse janë për familje të dëshmorëve, Kryetari ka mujt me i dhënë me negociim.

Avni Bytyqi - çështja e negociimit është e përcaktuar me ligj se ku Kryetari ka të drejtë dhe për çka me hy me negociim. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime dhe thotë që nuk ka të drejtë Kryetari me hy me negociim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - a mundet me u definu në inicim çështja që me u nda për kategoritë?

Avni Bytyqi - askush kërkujt nuk ka të drejtë me ia kufizu të drejtën e aplikimit për pronën publike private.

Dardan Berisha - borgji që është akumuluar aty, sa lejohet tash me marrë dikush tjetër pa u pastru ai borgj?

Urim Suka - drejtor, cili është veprimi yt për uzurpatorët e tjerë që kanë prona publike dhe krijojnë të hyra prej aty dhe kanë obligime ndaj teje?

Armend Krasniqi - jemi duke e detajizuar listën dhe aty ku është e mundur me ndërhy, aty jemi duke ndërhy. Sot kemi fillu një procedurë tjetër për lirimin e dy uzurpatorëve tjerë, javën tjetër do ti lirojmë dy të tjerë. Çdo ditë në Drejtorinë e Pronës dhe Katastrës punohet në këtë drejtim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - është vendim i mirë dhe i qëlluar por paraprakisht është dasht me pas një raport sa u mbështet dhe një raport prej bashkësisë islame për numrin e përfitimit të familjeve. Ka ndonjë rast që është shkru dhe ka marrë dikush tjetër ndërsa familja s'ka përfitu.

Avni Bytyqi - dua të ju njoftoj që ne kemi pas disa takime gjatë pandemisë me Kryeatrin dhe rreth 400 ka qenë numri i të vdekurve çdo vit dhe çdo vit sillet rreth 400. Asnjë cent nuk i shkon familjes, këto para i shkojnë bashkësisë islame dhe bashkësia islame i mbulon të gjitha shpenzimet e varrimit.

Liridon Fandaj - p.sh. nëse mua më ka vdek një familjar dhe shpenzimet e varrimit i kam kryer vet e dikush ka përfitu në familjarin tim. Unë të paktën dua ta kem një list se kush ka përfitu.

Urim Suka - financimi po shkon te bashkësia islame. A është mendu që financimi me shku te familja drejtpërdrejtë? A është më mirë me shku drejtpërdrejtë te familja dhe me u rrit vlera edhe pak dhe a është baza ligjore me bë këtë marrëveshje me bashkësinë islame?

Avni Bytyqi - prej 2010 komuna jonë e subvencionon çështjen e shpenzimeve të varrimeve. Një periudhë i kemi subvencionu drejtpërdrejtë qytetarët por kemi pas ankesa prej bashkësisë islame dhe kemi pas ankesa që ata nuk i kanë sjell certifikatat e vdekjes dhe si pasojë ne kemi pas problem me i lëshu subvencionet. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Dardan Berisha - në vitin 2017-2021 gjatë mandatit të legjislaturës së kaluar ne si grup i asamblistëve të PDK-së kemi kërku me i subvencionu përmes bashkësisë islame dhe kemi shku në vlerën 200€ dhe tash me sa e di bashkësia islame ka kërku me u rrit vlera. Atë që e tha Liridoni, shumë është e vërtetë që e kanë keqpërdor qytetarët. Unë sot i kontaktova bashkësinë islame dhe i pyeta se a kanë ekip dhe thanë që kanë ekip. Ka shumë që vdesin nëpër spitale në Prishtinë ose në Prizren dhe kjo ekstra duhet të paguhet sepse këta e kanë vetëm territorin e Suharekës. Është mirë me propozu dhe m'i shtu edhe 50€ dhe të bëhet 300€.

Kryesuesi - ne do ta diskutojmë në Asamble dhe nëse ka nevojë për transport ne e rrisim shumën.

Sanie Kuçi Rexhepaj - a është vetëm për banorët e komunës së Suharekës?

Avni Bytyqi - duhet me qenë banor i komunës së Suharekës.

Dardan Berisha - çështja tjetër është që ka shumë qytetarë që nuk e dinë se si shkon procedura dhe duhet të bëhet një njoftim prej drejtorisë së shëndetësisë.

Liridon Fandaj - duhet të dinë kush është donacioni sepse ka dikush që nuk do me u marrë me bashkësinë islame.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7. Shyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e Artë” , “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori” ;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - jam pro këtij vendimi mirëpo bashkangjitur me të është dasht ta kemi edhe raportin e punës së anëtarëve të komisionit, propozimet që janë bë sepse me sa e di unë ka pas edhe disa propozime tjera dhe dua ta di se si kanë qenë votat.

Kryesuesi - kanë qenë 11 kërkesa në total. Komisioni i ka shqyrtu dhe ka vendos sipas rregullores.

Daedan Berisha - është mirë me qenë transparent edhe me familjarin.

Avni Bytyqi - dilema ka qenë vetëm te çmimi “Emblema e Artë” dhe ka qenë 3 për, 3 kundër dhe ka vendos Kryesuesi kurse me çmimet tjera ka qenë në rregull.

Sanie Kuçi Rexhepaj - absolutisht puna e komisionit është e vështirë kur ke me nda një mirënjohje të tillë dhe e përgëzoj komisionin. Ne si grup i grave i kemi pas propozimet tona ku njëri prej propozimeve ka kalu dhe s'është diçka që duhet me u merakos se kush e dha votën për e kush kundër për shkak se në procesverbal nuk shenon se kush votoi për e kush kundër por vetëm numri i votave sa kanë qenë për dhe sa kundër.

Urim Suka - është një çështje e ndjeshme kjo situatë sa herë vjen dhe nuk duhet me qenë një pikë që na ndan por që na bashkon por gjithmonë është mirë komisioni me qenë transparent nëse don dikush me pas qasje. Nuk e di a janë kry familjet e dëshmorëve pastaj familjet e viktimave nuk e di a kanë marrë dhe

mendoj që duhet me marrë edhe familjet e viktimave dhe kush do tjetër që e ka dhënë një kontribut. Është mirë me pas një pasqyrë në këtë drejtim dhe me shku secilit me i dhënë.

Avni Bytyqi - vitin e parë kur është themelur ky çmim, të gjithë dëshmorëve të komunës së Suharekës bllanko iu ka dhënë ky çmim dhe s'ka nevojë me sjell në kuvend por vetëm duhet të njoftohet Kryetari për familjet të cilat nuk e kanë çmimin "Skënderbeu" në cilësinë e dëshmorit pastaj komuna ia punon mirënjohjen dhe ia dërgon.

Liridon Fandaj - disa propozime janë bërë si komunë drejtuar nivelit qendror të Presidentes që i ka shpall hero vitin e kaluar. A duhet Kryetari me i dërgu propozim për ato familje, me bërë kërkesë për shpallje hero apo me iu drejtu komisionit?

Avni Bytyqi - nëse mendoni për dëshmorët mendoj që propozimet i bën kryetari i shoqatës.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2023 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. ;

Kryesuesi - hap debatin për pikën 8.

Liridon Fandaj - kur kanë vendos të vazhdimi në bazë të performacës i anëtarit të bordit, a kanë pas të drejtë pa shpall konkurs me vazhdu.

Avni Bytyqi - është çështje e komisionit që ka vepru ashtu.

Liridon Fandaj - a e ka këtë të drejtë komisioni me vazhdu pa shpall konkurs në bazë të performancës?

Avni Bytyqi - është në diskercionin e tyre se a duhet me vazhdu pa konkurs ose me konkurs.

Liridon Fandaj - në bazë të cilit ligj, nën janë bazu?

Kryesuesi - më detajisht do ta marrësh një përgjigje nga anëtarët e komisionit në asamble.

Liridon Fandaj - nëse ata nuk mund të na japin sqarime për pasqyrat financiare, duhet të jetë financieri i tyre sepse i kam disa pyetje sa i përket pasqyrave financiare dhe disa ndryshime që janë.

Urim Suka - një pikë më bëri përshtypje në raport dhe dua ta marrë mendimin e drejtorit. Thotë që stacioni i autobusëve nuk është i licencuar për me ushtru veprimtarinë e vet sipas ligjit dhe arsyeja se pse nuk është e licencuar thotë që Drejtoria e katastrofës nuk e ka bërë licencimin. Pse mos me kry një shërbim të tillë? Sa lokale i ka në shfrytëzim stacioni i autobusëve, sa i ka dhënë me qera dhe sa të hyra krijon?

Armend Krasniqi - faktikisht me këtë çështje nuk është marrë askush mirëpo para dy jave e kam bërë ekzekutimin e stacionit të autobusëve në katastrofë ku ka qenë kjo pronë e pylltarisë mirëpo pas analizave që i kemi bërë si sektor kemi marrë përgjegjësinë që mos ti lëmë 40 punëtor pa punë që punojnë në stacionin e autobusëve. Kemi një ankesë ku ne ia kemi refuzu dhe agjensioni kadastral ka me ia refuzu. Po ashtu tash mund t'ia bëjmë një inicim të një procedure tjetër ku po mendoj që stacionit të autobusëve duhet me ia dhënë një pamje tjetër sepse e ka një pamje jo të mirë. Nuk i kemi të regjistruar sa lokale janë por shumë shpejt do ti regjistrojmë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8.

4 për, 2 apstenime Miratohet Pika 8

Kryesuesi - e hap debatin për pikën shtesë. Nuk ka debat, e hedh në votim pikën 9 shtesë.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi: **14:15**

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj